



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Nenit 5, pika d. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 2, paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Edukativ-Arsimor dhe Aftësues (IEAA) Nr. 08/2014:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) SHPALL

KONKURS

PËR KËTO POZITA:

Nr.	Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita	Kodi i pozitës
1	SHFMU	Emin Duraku	Prishtinë	Drejtor	1
2	SHFMU	7 Marsi	Prishtinë	Drejtor	2
3	SHFMU	Xhemail Mustafa	Prishtinë	Drejtor	3
4	SHFMU	Hilmi Rakovica	Prishtinë	Drejtor	4
5	SHFMU	Avni Rustemi	Mramor, Prishtinë	Drejtor	5
6	SHFMU	Ali Kelmendi	Barilevë, Prishtinë	Drejtor	6
7	SHFMU	Ditët e Minatorit	Kishëz, Prishtinë	Drejtor	7
8	SHFMU	Fan S. Noli	Marevc, Prishtinë	Drejtor	8
9	SHFMU	Ganimete Tërbeshi	Llukar, Prishtinë	Drejtor	9
10	SHFMU	Isa Boletini	Busi, Prishtinë	Drejtor	10
11	SHFMU	Rilindja	Keqekollë, Prishtinë	Drejtor	11
12	SHFMU	Shkolla Model	Prishtinë	Drejtor	12

13	SHML	Sami Frashëri II	Prishtinë	Drejtor	13
14	SHML	Gjimnazi i Matematikës	Prishtinë	Drejtor	14
15	SHFMU	Dardania	Prishtinë	Zëvendësdrejtor	15
16	SHFMU	Elena Gjika	Prishtinë	Zëvendësdrejtor	16
17	SHFMU	Faik Konica	Prishtinë	Zëvendësdrejtor	17
18	SHFMU	Gjergj Fishta	Prishtinë	Zëvendësdrejtor	18
19	SHFMU	Hasan Prishtina	Prishtinë	Zëvendësdrejtor	19
20	SHFMU	Naim Frashëri	Prishtinë	Zëvendësdrejtor	20
21	SHFMU	Hilmi Rakovica	Prishtinë	Zëvendësdrejtor	21
22	SHML	Hoxhë Kadri Prishtina	Prishtinë	Zëvendësdrejtor	22

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të Ligjeve që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068, Ligji Nr. 04/L-32 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2014.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore;
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit ose të jenë në procedurë të licencimit;
- Të kenë së paku 3 vjet përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim (kandidatët që me rastin e aplikimit nuk e plotësojnë këtë kusht, duhet që deri në fund të procesit të përzgjedhjes të përfundojnë së paku një program, sepse në rast të përzgjedhjes së tyre nuk mund të bëhet emërimi pa e plotësuar këtë kusht, ashtu siç kërkohet nga Neni 34, Pika 5 e Ligjit Nr. 04/L-32 – Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës).

Aplikacioni i kompletuar duhet të ketë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë) ose shkarkohet nga ueb faqja e komunës;
- Dokumentet personale (certifikata e lindjes dhe letërnjoftimi ose pasaporta);
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat);
- Çertifikatat e trajnimeve të përfunduara;
- Dëshmi se ka licencë të mësimdhënësit ose që është në procedurë të licencimit;
- Dëshmi të përvojës së punës në arsim;
- Portfolio profesionale (sipas udhëzimeve në Shtojcën G të UA 08/2014);
- Letër-referencë nga një institucion publik kredibil (si MASHT, DKA, Këshilli Drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë). Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimet paraprake;
- Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësuese për të cilin konkurren (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, me font të shkronjave Arial, madhësia 12) sipas udhëzimeve të MASHT;
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja shëndetësore e kandidatit;
- Dëshminë se kandidati nuk është nën hetime;

Sqarime shitesë:

Që prej shpalljes së konkursit e deri me rastin e intervistimit, të gjithë kandidatëve për drejtorë a zëvendësdrejtorë u ofrohet qasje në të dhënat e IEAA-së ku ata konkurrojnë dhe mund të kenë takime me personelin e atij IEAA, në mënyrë që të mund të përgatiten për konkurs dhe për intervistë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.

Që prej shpalljes së konkursit, kandidatët mund ta shkarkojnë nga ueb faqja e Komunës së Prishtinës dokumentin ku përshkruhet procedura e përzgjedhjes së drejtorit/zëvendësdrejtorit të IEAA-së.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi është i hapur prej datës 18 korrik deri më 1 gusht 2014. Aplikacionet mund të dorëzohen çdo ditë pune nga ora 09:00 - 15:00.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në komunë - DKA përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës.